

PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATËS 22.09.2023

Kryesuesi i mbledhjes është: Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi

Ora e hapjes së mbledhjes: 10:00

Zhvillimi i mbledhjes: në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 33

Sekretari i Këshillit deklaroi kuorumin prej këshilltarësh:33

Këshilltarë gjatë mbledhjes : 35

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: zv/kryetari Kletjon Kita dhe drejtorë

Të pranishëm në mbledhje qytetarë:

Pika 1 e rendit të ditës.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka erdhur nje shtesë për tu futur në rendin e ditës që ka të bëjë me rishpërndarjen e banesave sociale është një person i cili duhet trajtuar po për shkak të plotësimit me vonesë të dokumentacionit po e futim së bashku me materialin vijues të erdhur nga ekzekutivi dhe unë kërktoj mendimin tuaj për ta futur ne rendin e ditës .

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 33

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Kjo kalon si pika 6 e rendit të ditës me pas cdo pike e rendit të ditës do të zhvendoset me një numër në vijim.

Pika 1 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 33

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 2 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 31- GUSHT 2023

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka diçka ne lidhje me këtë material?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 33

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 3e rendit të ditës

MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE, DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIU DHËN 1 – 31 GUSHT 2023.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Komisioni ju lutem

Këshilltare A.Taho: Përshendetje të gjithëve mbas takimit të përfaqësuesve të kujdesit social në Bashki ne kemi marrë informacionin e duhur për 64 familjet që përfitojne nga ky fond , 27 familjet që përfitojne nga kompesimi i energjisë elektrike 15 familjet që përfitojne ndihme ekonomike por nga fondi i buxhetit vendor. Komisioni ka vendosur tja kaloje këtë material këshillit për ta miratuar.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka diçka lidhur me këshilltaret?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 33

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 4 e rendit të ditës.

PËR NJË KORRIGJIM TË TABELËS BASHKANGJITUR NË VENDIMIN NR. 114 DATË 31.08.2023 "MBI MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA".

Këshilltare A.Taho: Edhe për këtë pike jemi informuar nga Drejtoria e Shërbimit social dhe ishte një vlerë shumë e vogël që ishte llogaritur gabim por që nuk ndryshonte shumën totale të përfitimit për zonjen në fjalë , komisioni ka vendosur që ta kalojë dhe këtë material për votimin në Këshillin Bashkiak.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 33

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 5 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA.

Këshilltare A.Taho:Pas informacionit kemi vendosur si komision pa pasur asnjë kundërshtim që dhe kjo pikë të kalojë në këshill për miratim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka diçka tjetër nga këshilltarët?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 33

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 6 e rendit të ditës.

PER RISHPERNDARJEN E BANESAVE SOCIALE ME QIRA.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Eshtë materiali që ne ja u vume ne dispozicion i cili ka të bëjë edhe me një shtesë edhe të një personi tjetër i cili ka plotësuar dokumentacionin me vonesë por mendohet që të futet ne rendin e ditës për shkak të vështirësisive dhe problemeve që ai ka.

Këshilltare A.Taho: Duke qënë se materialin e kemi marr pak me vones jemi konsultuar dhe me anëtarët e tjerë të komisionit , kemi të bëjmë me një familje në nevojë për emergjence kshu që mendojm duhet tja kalojmë dhe ti propozojme këshillit për miratim edhe për këtë pikë.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 33

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 7 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË TË ARDHURAVE DHE PËRDORIMIN E GRANTIT PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "PËRFSHIRJE SOCIALE PËR NDRYSHIM", MIDIS BASHKISË KORÇË DHE PROGRAMIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR ZHVILLIM (UNDP).

Këshilltare A.Taho: Komisioni u njoh me miratimin e planit të të ardhurave për përdoriminin e grantit mori dhe informacion nga përfaqesuesi i bashkisë dhe vendosi që ta kalojë për miratim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Komisioni i Mirëqënies ka diçka ?

Këshilltare A.Taho:: Ne këtë ja kemi lënë komisionit për ne ishte cdo gje ok , vlerat ishin të përcaktuara në relacion keshu që mendojme ta kalojme për miratimin e Këshillit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje ?

Këshilltare I.Seidolli: E para këtu është perfituar nje grant me vlerë 30 milion lekë dhe Bashkia është bashkë financuese me një vlerë tjetër qe është 7 milion lekë të vjetra. Pyetja e parë është nëse kjo vlere 7 milion lekë është pjese e grantit në bazë të

marëveshjes apo është ekstra pra ne total i bie te jenë 30 milion lekë apo janë 37 milion lekë?

Pyetja e dytë :

Në këtë projekt është aplikuar së bashku me këto pika , domethëne ky fnd grant është specifikuar për zërat që janë paraqitur këtu me këto nëndarje apo thjesht është aplikuar duke shpjeguar situatën e përgjithshme ?

[Pyetja e trete: Në pikën e parë kërkohet shqyrtimi i këtij fondi me vlere 4 milion lekë të vjetra për krijimin e rrjetit lokal të paleve të interesuara , në çfarë konteksti do të harxhohen keto para dhe shpjegimi poshtë nuk me le të kuptoj se konkretisht këto 4 milion leke drejt çfare do te harxhohen, krijimin e burimeve njerëzore , për implementimin e këtij projekti drejt ksaj faze të përzgjedhjes?

Së fundmi kërkohet të harxhohen 3 milion e gjysëm për trajnimin profesional për të rinjte, për orientim drejt kërkesave të tregut me poshtë specifikohet që ne trajim do të marrin pjese vetëm 15 të rinj .

Pse kaq pak te rinj , a i përkasin këta të rinj një kategori të caktuar sociale apo kanë probleme ekonomike pra nga rrjedhin këta të rinj që keni perzgjedhur dhe si do të bëhet përgjedhja ?

Ekzekutivi M.Balli: Për sa i takon pyetjes të parë ne lidhje me fondin 3 milion lekë të rinj janë nga Imunibia dhe 649 mijë lek janë përcaktuar kontribut në natyrë nga Bashkia si burime njerëzore , vetë stafi i Drejtorise të Kujdesit Social do të anagzohet për të implemtuar këtë projekt.

Këshilltare I.Seidolli: Në total i bie të jenë 37 milion lekë , në total i koston të gjithë projektit ?

Ekzekutivi M.Balli : 3 milion lekë është kontributi i Bashkise nga burimet njerëzore dhe ambienti ku do të zhvillohen aktivitetet . Përsa i takon pyetjes të dyte ne lidhje me aktivitetin numër 1 ka të bëjë me realizimin e trajnimit komplet stafit të Drejtorisë të Kujdesit Social pra 20 persona staf të kujdesit social do të trajnohen , për sa i perket pyetjes të treët ne nuk kemi bërë përzgjedhje të të rinjve pasi do bëhet shpallja dhe cdo i ri që ka mundësi të marr pjese ne trajnimn do te marre kemi erdhur iketu per te perzgjedhur grante po nuk janë perzgjedhur akoma të rinjtë derisa të bëhet shpallja cdo i ri mund të marrë pjese në trajnimin që do të realizohet.

Këshilltare I.Seidolli: Ka ndonjë kategori që do të favorizohet ?

Ekzekutivi M.Balli : Patjetër , kategoria e parë janë të rinje me probleme sociale.

Këshilltare I.Seidolli: Ka një afat kohor për këtë përzgjedhje ?

Ekzekutivi M.Balli: Afat kohor nuk ka.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 35

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 8 e rendit të ditës.

MBI MIRATIMIN E PROJEKT DOKUMENTIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2024-2026, TË RISHIKUAR.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kjo është një procedurë cdo 3 mujor duhet bërë aplikimi edhe në bazë të sygjerimit që ka dhënë Ministria e Fiancave, materiali është shpërndarë ka diçka?

Këshilltare A.Taho:Komisioni pasi shqyrtoi dokumentin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 , pasi bëri dhe pyetje e nevojshme mori dhe sqarime nga ekzekutivi vendosi ta kalojë për miratim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka diçka tjetër nga këshillatret?

Keshilltare I.Seidolli: Kisha disa pyetje në lidhje me projektbuxhetin.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kisha diçka tjetër , nuk e di nëse jeni pjesë e komisionit apo jo , duke qenë se materiale është shpërndarë nëqoftëse ka diçka që ju e keni të paqartë në lidhje me materialin është mirë që me ekzekutivin të merni informacionin e duhur , nuk ka rëndësi nëse jeni pjesë e komisionit apo jo.

Këshilltar L.Petri: Thatë pak më parë ti drejtohem ekzekutivit nëqoftëse kemi një paqartësi , ku duhet ti drejtohem?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Në drejtoritë përkatëse sipas drejtorive.

Sekretare e Këshillit E.Naci : Paraqite si kërkesë me shkrimi cdo lloj informacioni që të duhet.

Këshilltare I.Seidolli: Duke parë projektbuxhetin 2024-2026, duke u nisur dhe nga fakti i ekonomisë së rënduar që buqësia po paraqet kohet e fundit dhe nga investigimi që ne

kemi bërë në terren shoh që tarifatat janë në të njëjten shumë, nuk është bërë asnjë përpjekje qoftë për ti ulur ose për ti ngritur , do të doja që të planifikoheshë që tarifatat për ndricim ose për gjelbërim ne zonat rurale të hiqeshin ose minimalisht të uleshin dhe kjo të planifikohëj për vitet në vijim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kjo nuk është pyetje kjo është mendim.

Këshilltari I.Seidolli: Do doja të dija sa subjekte do paraqiten si debitore për vitin 2023 dhe te keto debitore sa janë të paarketueshëm se dua të llogaris në njëfarë mënyre cila është arseja që taksat priten të jenë në rritje gjatë viteve në vijim krahasuar me vitin 2023 dhe nëqofte se qëndrat shëndetësore janë në varësi të Bashkisë të Korçës në zonat rurale dhe në qofët se është planifikuar rikonstruktimi i tyre.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ajo ishte arsyeja që unë fola pak më parë dhe thashë të projektoheni në mbledhjet e komisionit apo mos e kërkoni informacionin ashtu si ka kërkuar Elvini tja japim nga ekzekutivi , sepse ekzekutivi ka shifra ekzekutivi nuk mund të vijë dhe të thotë kaq është shifra megjithatë ekzekutivi ju jep mundësi të komunikoni me njëri tjetrin dhe të qartësoheni sa debitore janë , sa është kjo vlerë sepse kjo nuk është një çështje që ndihmon këtë pjesë këtë pikë të rendit të ditës sepse ky është një material i cili është sygjeruar para këshillit janë dërguar në Ministrinë e Financave për të bërë ekonominë dhe riktheht përsëri në Këshill.

Ekzekutivi M.Balli: Pyetjet e shtruar nga ana juaj nuk kanë lidhje me materialin , pasi këtu është paraqitur materialin për miratimin e buxhetit të fazës në buxhetin e rishikuar afat mesëm 2024-2026 që do të thotë ju betë një pyetje në lidhje me tarifatat në lidhje me buqësinë debitore këto informacione kërkohen në momentin që fillon hartimi i buxhetit të vitit pasardhës, nuk mund të shtrohen këto pyetje në mbledhje për shkak se tarifatat janë miratuar që në fillim në janar , u është bërë vlerësimi për parashikimet afatmesme dhe ne bazë të kësaj dhe të udhezimit të Ministrisë të Financave për tranferten e pakushtëzuar dhe transfertat e pakushtëzuara sektoriale janë llogaritur tavanet e buxhetit të cilat janë llogaritur në fund të marsit dhe në fund të korrikut dhe në bazë të tavanëve fillon dhe puna për hartimet e buxhetit afatmesem, pra pyetjet nuk kanë lidhje me materialet. Duke u miratuar tavanet ne në baze të tavanëve hartojmë buxhetin me 11 programe, duhet të theksojmë se Bashkia Korçë është Bashki pilot e përgjedhur nga Ministria e Financave dhe nga projekti për financat lokale ku buxheti hartohet me 11 programe dhe produkte të cilat janë të shumëllojshme dhe ju i keni në instrumenti i planifikimit financiar në lidhje dhe me debitorët përsëri kjo pyetje nuk qëndron në material sepse këto paraqiten gjatë parashikimit të të ardhurave të viti buxhetor pasardhës ndërsa në lidhje me qëndrat shëndetësore janë në pronësi të Bashkisë por investimet parashikohen gjithmonë nga Ministria e Shëndetësisë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me materialin?

Këshilltar K.Pllaha: E di që mund të pyesë në komision ose të paraqitem në ekzekutivi por është procesi i transparencës me publikun dhe në rast ku diskutohet buxheti publikut i interesojnë 2 gjëra sa paguan taksa dhe ku shkojnë këto taksa dhe unë shoh në

parashikimin për vitin 2023 ka rritje në total të taksave pra të sasise të të ardhurave që do mbledhë bashkia nga tarifat vendore, përshembull po mar taksën për infrastukture apo taksën e pasurive të palujtshme, pyetja në lidhje me këtë është nese kjo rritje total është për shkak se është shtuar numri i pasurive të palujtshme apo ndërtimeve të reja apo ka një rritje të tarifës?

Dhe për sa i përket shpenzimit shoh që ka një rritje të konsiderueshme të shpenzimit për shpenzime personeli e cila një masë justifikohet nga rritja e pagave dhe e pagës minimale po nga ana tjetër ka një rritje të shtuar të administratës të Bashkisë nga 240 punojës në 370 që është rreth 50% më shumë dua të di kjo rritja e administrës në cili sektor është shtuar dhe pse ka qënë e nevojshme?

Faleminderit.

Nënkryetari i bashkisë K.Kita: Për pjesën e taksës ne duhet ta dimë që implatojmë një pakete fiskale në fund të vitit për vitin 2023 nuk kemi futur as rritje as ulje të taksave paketa fiskale është e miratuar dhe nuk ka ndryshuar që nga data që është miratuar dhe në vazhdim.

Këshilltar K.Pllaha: Ky ishte krahasim me vitin 2022 në krahasim me vitin 2022 ka ndryshuar në rritje dhe ne nuk kemi qënë prezent kur është miratuar paketa fiskale dua të pyes në parim nga viti 2022 tarifat vendore të pasurisë të palujtshme kanë rritje?

Nënryetari i bashkisë K.Kita: Ne miratojmë paketën fiskale dhe në paketën fiskale kemi miratuar tarifat për taksat e ndërtesave dhe ndikimi në ifrastukturë nuk kemi as rritje as ulje të taksave sepse nuk kemi futur material për paketën fiskale këtu llogaritja është bërë sipas bazës që kemi ne të të dhënave që kemi nga Drejtoria e Hipotekës nuk ka rritje të taksave dhe të nivelit të tyre .

Këshilltar K.Pllaha: Nga 2022 deri ne 2023 nuk ka rritje ?

Nënryetari i bashkisë K.Kita: Nuk ka rritje.

Këshilltar K.Pllaha: Atëhere është shtuar numri i godinave?

Nënkryetari i bashkisë K.Kita: Eshtë shtuar numri i godinave është bërë identifikim në terren kemi marrë materiale nga hipoteka dhe kemi bërë llogaritjet, janë shtuar dhe debitorët që kemi pasur ndër vite dhe është bërë kjo llogaritje.

Këshilltar E.Nexhipi: Për vitin 2023 nuk ka pasur një ndryshim të tarifave sepse ka dhe një kufizim ligjor për këtë ceshtje gjatë vitit zgjedhor nuk lejohet as ulja as ngritja, është e përcaktuar pra nuk ka pasur parashikimi i të ardhurave në ato 2 zëra ka ndodhur sepse ndërtimi është parashikuar do rriteshe këtë vit pra nuk është rritur si zë tarife por është rritur si parashikim sasie ndërtimi dhe me pas sipas parashikimit të transaksioneve që ka erdhur nga ASHK , pra prandaj e cilësova këtë unë e kuptoj dhe dëshiren për ti diksutuar gjërat nga këshilltaret e rinj por disa informavione mund të merren paraprakisht mund të diskutohen me ne qofte edhe neper kafe si keshillatre te vjeter nuk eshte ndonje problem,

për të qene më racionale këtu dhe për të dhënë atë që duhet megjithatë të lirë jemi për të thënë atë që duam si të duam.

Këshilltar K.Pllaha: Unë respektoj zotin Nexhipi dhe e falenderoj që na jep mbështetje dhe na jep mundësi për tu konsultuar si këshilltar i vjetër por pyetjet janë racionale dhe nuk bëhen thjesht për informacionin tonë por bëhen për të qënë transparente me qytetarët dhe pyetjet që mund tju drejtoj ju ne kafe apo dhe komisionit nuk janë publike ndërsa ato pyetjet që bëhen këtu dhe sidomos përgjigjet janë për transaprencën me qytetarët Korçarë të cilët ne e kemi detyrim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka ndonjë pyetje ?

Këshilltar L.Petri: Po ja pasoj koleges të drejtën e pyetjes.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nuk është me pasim.

Këshilltare I.Seidolli: Duke qënë se unë jam kundër projekt vendimit me lejohet sipas ligjit që të shpjegoj arsyen time pse jam kundër.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Do ju jap fjalën për diskutim, ka pyetje të tjera ? Ekzekutivi nëqoftëse ka dicka për të thënë.

Këshilltar L.Nako: Domethënë nuk paskemi të drejtë më shumë se njeherë të pyesim?

Këshilltare A.Taho: Nëse i referohemi tabelës të paraqitur janë 1270 punojës,ky është numri total i pozicioneve të parashikuara sipas buxhetiti,nderkohë që 1050 punojës janë të punësuar në bashki dhe ndërmarjet e varësisë nuk ka shtesë punojësish me 200 veta por 1270 është parashikimi që kemi bërë për 2023 janë punësuar1050.

Këshilltare I.Seidolli: Diskutimi im lidhet me shpenzimet kapitale që paraqiten në ulje.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka ndonjë pyetje ?

Këshilltare I.Seidolli: Dhe nuk me duket normale në lidhje me arsimin dhe shërbimet publike të cilat përseri janë në ulje dhe duke u nisur nga këto të treja, shumë serioze për mendimin tim që arsimi planifikohet të jetë në ulje dhe investimet publike planifikohen të jenë në ulje dhe pagat planifikohet të jenë në rritje është problem , e dyta buqësia,smartcity dhe turizmi ishin 3 prioritetet e Bashkisë Korçë. Nëqoftese ju shikoni shumen totale në projeksion si janë në rritje apo ne zbritje për buqësinë ato janë qesharake në sensin që kur Bashkia 1 degë e ka prioritet ajo investon atje, nëqoftese ju e shikoni ato lëvizin me 10 mijë lek të reja. Kështu që unë nuk e di nëqoftese një degë prioritare si buqësia do të kishte këtë lloj niveli shumë për ta quajtur atë degë prioritare ku Bashkia është e interesuar të investojë me këtë rritje kaq qesharake dhe a mundet realisht një dege të jetë...

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Këto nuk janë pyetje.

Këshilltare I.Seidolli: Po i bëj retorike dhe nuk besoj se kjo del jashtë kontekstit. Unë mendoj që pyetjet e mia janë retorike dhe janë mjaft të qarta dhe për publikun. Buqësia nuk mund të jetë degë prioritare nëqoftëse nuk investohet si duhet, nëqoftëse ky është plani juaj afatgjatë.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 4

Vota ABSTENIM 6

Pika 9 e rendit të ditës.

’PËR KALIMIN E PRONËSISË SË TRUALLIT PREJ 240 M2 TË DHËNË PËR NDËRTIMIN E PUNISHTES SË PËRPUNIMIT TË QUMËSHTIT NË FSHATIN DISHNICË, NGA ISH KËSHILLI I KOMUNËS BULGAREC, NË EMËR TË Z.APOSTOL KAPURANI, PËR EFEKT REGJISTRIMI NË REGJISTRIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME”

Këshilltar K.Kocibelli: Atëhere në mbledhjen e ditës të hënë komisioni i ligjeve bëri verifikimin e të gjithë dokumentacionit të personit fizik i cili është drejtuar bashkisë Korcë duke qënë se me vendimin e Këshillit të Ministrave 329 të vitit 2019 është rregulluar mardhënies juridike për sa i përket edhe fitimit të pronësise të këtyre shtetasve dhe të gjithë atyre shtetasve që para kësaj VKM nuk janë pajisur me certifikatën e pronësise dhe pasi kjo VKM është futur në fuqi , kushdo mund ti drejtohet Këshillit bashkiak ose Bashkisë për tu bërë dhe ai pronar i pasurise të palujtshme, përvec pasurisë që është objekt , është pronar i objektit të pronësise në këto kushte komisioni duke qënë se ishte i plotësuar vendosi tja kalojë Këshillit për miratim.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 35

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 10 e rendit të ditës.

'PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR TË KËRKUAR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT SISTEMIM I RRUGËS ANDREA STATHI'.

Këshilltar K.Kocibelli: Në lidhje edhe me këtë pikë bazuar në ligjin 8569 të vitit 1999 që ka të bëjë në lidhje me shpronësimet gjithashtu edhe për sa i përket VKM-se numër 89 të vitit 2016 është përcaktuar vlera sipas cilës zone kadastrale të Republikës të Shqipërisë, ndodhur në këto kushte për sa i përket se jemi para një interesi publik që është shpronësimi i rastit konkret kjo sipërfaqe prej 181 m/ katror edhe sipas vlerës që është përcaktuar nga VKM 89 ne e pame të arsyeshme që ta kalojmë për miratim në Këshillin Bashkiak, duke qënë se kjo kërkesë ishte në përputhje me ligjin.

Këshilltar E.Bregu : Nëse pronari do të shpronësohet është dakort me vlerën e paraqitur, ajo që dua të them unë vlera e shpronësimit që i takon pronarit është në përputhje me kërkesat e tregut.

Këshilltar E.Nexhipi: Ankesë pronari do të paraqesë pasi të marrë me vendim se në këtë moment pronari sdi gjë .

Këshilltare S.Dinellari : Deri tani kërkuam seriozitet me pyetjet dhe përgjigjet kështu që kur flasim për seriozitet ta ruajmë nga të dyja palet,u tha këtu nëse jeni në dijeni për vlerën aktuale të kësaj prone dhe për dijenine e vlerës,ju thatë që nuk e dime se sa është vlera e tregut,a pra por për këtë duhet të jemi në dijeni sepse zona të caktuara në qytet kanë vlera të caktura ne e dime këtë pjese,e dyta personi në fjalë i cili po shpronësohet ka të drejtë të informohet me pronën e tij dhe me pas ne të shikojmë sesi do jetë reagimi që mos presim me pas reagime që mund të pengojnë në interes publik një tjetër mundësi,rruge apo dicka tjetër.

Këshilltare A.Taho: Meqenëse po flasim për seriozitet me referoni një dispozite ligjore që duhet të informoj ponarin.

Këshilltare S.Dinellari: Dispozita ligjore është drejta e pronarit, është nen në të drejtën Kushtetuese.

Këshilltare A.Taho: E drejta e pronesisë është kuptim shumë i gjerë,ju lutem më referoni.

Këshilltare S.Dinellari: Jo nuk është,lexoni Kushtetuten e keni nen të përcaktuar,e drejta e pronesisë.

Këshilltare A.Taho: Faleminderit për sygjerimin,do e mar parasysht.

Këshilltar I.Bode: E thënë shkurt që ne ja marrim pronën dhe nuk kemi detyrim që ti lajmërojme?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem dëgjoni me vemëndje përgjigjet.

Këshilltar I.Bode : Domethëne ja marrim ne.

Këshilltare A.Taho: Jo nuk ja marrim ne,ne thjesht bëjme një kërkesë që të filloj procedura e shpronësimit në këtë vendimarrje nuk po ja marrim thjesht po fillojmë procedurën e shpronësimit, ai që do vendos në fund nëse prona do jëtë në emër të pronarit ose të Bashkisë është Këshilli i Ministrave dhe po të shohësh ligjin për shpronësim nuk jam e detyruar ta njoftoj pronarin në fillim,pronari njoftohet pasi ne kemi paraqitur kërkesen në Këshillin e Ministrave votohet në fletoren zyrtare kërkesa tonë bashkë me vlerën përkatëse njoftohet pronari ka një afat 18 ditor për tu ankuar në lidhje me vlerën dhe me sipërfaqen dhe më pas Këshilli i Ministrave disponon me vendim,kjo është.

Këshilltar E.Nexhipi: Ju sygjeroj këshilltareve të shikojnë hartën me pas skiëcn sipas materialit që keni këtu ne e kemi përgjigjen që pronari vete është interesuar,aktualisht është rrugë por është në pronë.

Këshilltar I.Bode : Nga kjo skice nga e kuptoni ju që ky pronar është kaq i interesuar?

Kryetari i Këshillit A.Verushi:Ju lutem mos flisni pa rradhë, edhe njëhere komisioni u shpreh qartë nga ana ligjore dhe juridike,vendimet tuaja i dhatë ,ekzekutivi e dha përgjigjen e hedh ne votim,kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 2

Vota ABSTENIM 5

Pika 11 e rendit të ditës.

PËR RISHQYRTIMIN E V.K.B-SË NR.110 DT.15.08.2023 " PËR MIRATIMIN E HARTËZIMIT TË PJESSHËM TË ZHURMAVE .

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Komisioni.

Këshilltar K.Kocibelli: Këshilli Bashkiak Korçë në mbledhjen që kemi bërë online ka miratuar hartën e pjesshme ne 4 zona për sa i përket Bashkisë Korçë, ndërkohe që për sa i përket këtij materiali i është dërguar për konfirmim edhe Prefekti të Qarkut Korçë i cili ka kërkuar që sipas ligjit dhe sipas nenit 8 të bëheshe dhe njëhere verifikimi për sa i përket zonave të cilave do të bëhej hartëzimi ne cilat zone do të bëhej orari i përcaktur,në këto kushte ekzekutivi ka vendosur që këtë hartëzimi ta lejoj vetëm në 2 zona të caktuar nga 4 që ishte miratuar nga Këshilli Bashkiak Korçë, ndodhur në këto kushte dhe komisioni ja ka kaluar Këshillit Bashkiak për miratim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem lexoni këshilltare materialin.

Këshilltar L.Nako: Nuk janë pak materiale këtu dhe nuk mund ti lexojmë të gjitha brenda një kohe të shkurtër.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ne e kemi kaluar këtë material,e kemi miratuar vete këtë gjë.

Sekretare e Këshillit E.Naci: Atëhere me sa pash 1 kundër,2 abstenime pash të tjerët.

Këshilltar I.Bode: Kjo ishte një mbledhje online dhe me sa kuptova u bë me një emergjencë pasi ishte festa e birrës, u hodh për miratim orari i cili nuk u miratua, dhe nuk e mora vesh sesi u apovua vota ime sespe pasi dhash sygjërim me email me erdhi një email që tha vota ime ishte pro nuk e di si u miratua vota ime sepse nuk e shpreha mendimin tim.Tani për punën e orarit dhe zonave unë e shpreha dhe herën e parë skemi pse të mbajme me hatër disa zona dhe të penalizojme zona të tjera, të gjitha ata që kanë zgjedhur të punojnë në sektorin e shërbimit apo argëtimit duhet të jenë njësoj, ska pse pazari të jetë kaq i favorizuar dhe Pandën ta hedhim tutje, pra nëqoftëse do ketë një hartëzimi të qytetit skemi pse mbajmë me hatër disa zona dhe disa jo,dhe muzikën deri në një orë të caktuar ta lem për të gjithë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem secili e lexoi e ka të qartë, ky ishte mendimi juaj së pari në lidhje me pjesën e miratimit të atij vendimi të Këshillit që u bë online që Sekretaria ka administruar të gjitha votat e Këshilltareve një sqarim dhe me pas fjala është për ekzekutivin.

Sekretare e Këshillit E.Naci: Se pari nga këshilltaret po aludohet sesi meren votat, në momentin që ti nuk ke shprehur pro ose kunder do të thotë që ti abstenon.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem mos ndërprisni.

Sekretare e Këshillit E.Naci: Në momentin që ti nuk shprehesh as pro as kundër do të thotë që ti abstenon e para,e dyta nga këshilltarja Ismeralda me shkruan një informacion dhe i kam thënë nëse do të vish të gjitha janë të printuara që nga njoftimi i parë që ju është bere dhe deri në votat, emaillet çfarë ndodh që ju keni dërguar të gjitha janë në dosje dhe mund të vini ti shikoni që mos kalojmë në aludime të tilla jo ishin 11 vota apo ishin 12 vota.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem,fjala është për Anxhelën.

Këshilltare A.Taho: Për pjesën e hartëzimit këshilli i ligjit për mjedisin na ngarkuan me 2 detyra,e para është për krijimin e një dokumenti që është hartëzimi i zhurmave dhe planin e veprimt nga momenti, nga momenti që bëhet hartëzimi i zhuramve brenda një viti duhet të

bëjmë dhe planin e veprimit duke qënë se është një dokument i cili kërkon shumë punë ne jemi duke punuar dhe shumë shpejt do të vijë dhe në këshill hartëzimi për të gjithë qytetin duke përcaktuar edhe zonat edhe nivelet e zhurmesh sipas zonave dhe me vonë do viëj dhe plani i veprimit por u pa urgjente për këto 2 zona në vecanti të paraqitej një material vecmas por kjo nuk është që po trajtojmë njërën të nënës tjetrin të njerkës por do tju vijë harëtzimi për të gjithë qytetin,thjesht është çështje kohe.

Këshilltar I.Bode: Pse duhet patjetër që ne ta votojm këtë ?

Këshilltare A.Taho: Kjo u votua tani.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Atëhere e kemi hedhur në votim,kush është dakort me këtë pikë të rendit të ditës?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 32

Vota KUNDËR 1

Vota ABSTENIM 2

Pika 12 e rendit të ditës.

**RAPORTI I MONITORIMIT JANAR-GUSHT 2023, INFORMACION MBI ECURINË E REALIZMIT TË TREGUESVE KRYESORË TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE, PËR PERIUdhËN JANAR-GUSHT 2023.
(DREJTORIA E PËRGJITHSHME E FINANCËS,BUXHETIT DHE MFK)**

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kalojm në pikën 12 të rendit të ditës, ju lutem për informacionin ka diçka?

Këshilltar E.Bregu: Ju lutem mund ta marr fjalën?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem të mbaroj fjalën,ka diçka nga këshilltarët?

Këshilltar L.Petri: E kam në pikën pararendëse që ju e mbyllët me të shpejt, unë ngrita dorën kisha një koment për procedura dhe mua mu duk e pavend që mbledhja të bëhej me urgjencë dhe i kam dërguar një material Evës nuk e di nëse e ke ndarë me kolegët?

Sekretare e Këshillit E.Naci: Me kolegët e këshillit ?

Këshilltar L.Petri: Po.

Sekretare e Këshillit E.Naci: E kam ndarë me kryetaren.

Këshilltar L.Petri: Dakort dhe konsistonte ne faktin që ajo mbledhje urgjente që dihej se kur do të bëhej Festa e Birrës nuk kishte pse të bëhej urgjente dhe tjetra na jepej një material për tu miratuar që u bë me një procedurë po ose jo që për mua ishte gjithashtu no sens, i kam sygjerruar dicka sekretarisë të Këshillit që nëse bëjme mbledhje online duhet bërë të paktën ne formatin me video ose me audio që njerëzit të mund të dikutojnë të japim mendim dhe të mund të miratohet apo kundërshtohet nga kolegët,nuk mund të kalojmë në standartin e mbledhjes online një po ose jo të shkruar kështu me replay ne email.

Faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit dhe ju për sygjerimin ,sekretaria do të kujdeset edhe për këtë.

Këshilltar E.Bregu: Për procedurë në lidhje me këtë çështje,për sa i përket votimit online ose nëpërmjet platformave që përdoren nga Sekretaria e Këshillit Bashkiak email ose platforma whatsapp kam vene re që jo të gjithë janë të përfshirë në atë platforme, në whatsapp 20 pjesëmarrës këtu nuk janë të gjithë anëtarët e këshillit atëhere kjo platforme nuk ka pse të ekzistojë unë nuk do ta konsideroj më të ligjshme njoftimin në platformën whatsapp ose do të jenë të gjithë ose askush,nëqoftese ju doni të keni grup të tjera me interesat tuaja çështje tuaja mua sme intereson fare por këtu smund të jenë 20 pjesëmarrës në whatsapp dhe quhet njoftimii ligjshëm dhe votimi nëpërmjet emailt duhet që të gjitha votimet të ishin në të njejtën platformë të dukeshme për të gjithë dhe të gjithë anëtarët e Partise Socialiste janë pro nuk e ve në dyshim këtë por po flas thjesht për rregullore.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Sekretaria do të kujdeset.

Sekretare e Këshillit E.Naci: Po do të kujdem por whatsappin e kemi përdorur për të marrë njoftime të shpejta nuk e kemi përdorur ndonjëherë për të bërë votime.

Këshilltar E.Bregu: Tek email nuk i ke të gjitha njoftimet.

Sekretare e Këshillit E.Naci: Nuk i kam të gjitha njoftimet ?

Këshilltar E.Bregu: Po.

Sekretare e Këshillit E.Naci: Dhe ju lutem të ruani etikën sepse ka një etikë këtu të cilën ju e keni shkelur disa herë me mua.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Atëhere nëqoftese nuk ka diçka në lidhje me pikën 12 të rendit të ditës kalojm në pikën e 13: - INFORMACION NË LIDHJE ME INVENTARIZIMIN E AKTIVEVE AFATGJATA, AFATSHKURTRA DHE MATERIALE TË KLUBIT SHUMËSPORTESH PËR PERIUdhËN JANAR-QERSHOR 2023

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka ndonjë diçka nga këshilltaret për këtë informacion?

Nëse jo,kalojmë në kërkesat,ankesat e qytetaërve. Atëhere një kërkesë ka erdhur nga Shoqata Gruaja në Zhvillim e cila kërkon nga këshilltaret për realizimin e një projekti të saj në kuadër të projektit të cilën ajo po zbaton, është planifikuar një takim me rreth 20 të rinj nga Bashkia Korçë me disa anëtarë të Këshillit Bashkiak në sallën e mbledhjes të Këshillit. Synimi i këtij takimi është që këta të rinj të informohen në mënyre direkte nga vetë anëtarët e këshillit,komisionet dhe rolet e Këshillit Bashkiak dhe të mësojnë më shumë rreth procedurave të vendimeve që ndodhin në këtë institucion vendimarrës kjo do ti ndihmojë të kuptojnë më mirë angazhimin dhe kontributin e tyre si qytetarë të rinj të drejtimit të komunitetit tonë. Ato na janë drejtur për një numër relativisht nga 7 deri në 10 këshilltare të cilët do të bëhen pjesë e këtij takimi në një datë që do të përcaktohet nga vetë Shoqata Gruaja në Zhvillim. Nëse ka ndonjë këshilltar vullnetar që kërkon të jetë pjesë diskutimi të përbashkët,janë të lutur të paraqitin dokumentat e tyre nëse jo pastaj do të kujdesemi që të vendosim në disa këshilltare të alternuar midis 2 grupimeve politike të jenë pjesë e këtij takimi me këta të rinj. Ka ndonjë vullnetar që do të shprehet ?

Këshilltar L.Petri: Unë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Mendoj që të ketë edhe këshilltarë me eksperiencë, Erjon,Joani,Llamberto,Suela,Klajdi,Ismeralda,është i hapur dhe për të tjerë që duan të marin pjesë dhe do të njoftohen në grupi i këshilltareve për datën e takimit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka një kërkesë tjetër drejtuar Këshillit,të nderuar Këshilltare Shoqata Sportive Korça Multisport rregjistruar pranë gjykatës të Tiranës në aktivitetin e volejbollit të vajzave kemi qënë shumë të suksesshem për të gjithë grupmoshat 18-20 vjet,kemi dalë kampion,kemi fituar kupa.Të gjitha shpenzimet janë mbuluar nga vetë lojtarët e Shoqatës e shohim të arsyeshme tu drejtohem përfaqesuesve të qytetit për të na mbështetur në aktivitetin tonë,brenda mundësive dhe ligjeve. E para : Ne ndeshjet i kemi zhvilluar në qendra sportive e fëmijeve ku kemi paguar qera,duke qënë se fëmijet që ne kemi janë korçarë dhe ekipet përfaqesjne qytetin tone ky detyrim mund të hiqet për ne. Gjithashtu do të ishte një ndihmese e madhe nëse nga ana juaj do të aprovohej 1 buxhet për të na ndihmuar mbi mbullimin e shpenzimeve të transportit,sipas ligjeve në fuqi. Cdo Bashki mund të ndihmojë Shoqatat Sportive dhe që zhvillojnë aktivitetin në territorin e Bashkisë. Duke besuar në ndihmën tuaj, Me respekt nga Shoqata 'Ervis Saraci'. Kjo është një kërkesë e ardhur nga kjo shoqatë. Tani ekzekutivi icili por dhe drejtoria juridike për anën ligjore për mbështetjen e Shoqatave dhe së dyti për anën financiare.

Nënkryetari K.Kita: Tani me ligj tha dhe drejtoresha që nuk lejohet sponsorizimi për Shoqatën,në lidhje me tarifat që përdorim në Qytezën e Fëmijeve ka 1 bord që mer vendimin për ti bërë me pagesë ose jo dhe ka miratuar një tarifë për orën për shfrytëzimin e palestrës. Për sa i takon kërkesë të Shoqatës ne kemi pasur bashkëpunim me trajnerin i cili është tashmë i pezulluar nga Shoqata,kemi kërkuar disa nga bashkëpunimeve për vajza,sepse ju e dini që tani kemi ngritur një akademi volejboli në qytetin e Korçës në Skënderbeu ku kemi marre dhe tituj kampion me të rinj dhe të reja ,për sa i takon pagesës ajo nuk lejohet. Ne jemi dashamiërs që ti afrojmë të gjithë ata që janë të ineresuar për të ofruar jetën sportive në qytet,kështu që do i kthejmë dhe një

përgjigje me shkrim dhe kërkeses që kemi bërë nëqoftëse ka ndonjëri nga ju ndonjë sygjërim mund të na sygjëroni ta referoj në përgjigje.

Këshilltare S.Dinellari: Vetëm një sygjërim gjatë kohës që do të merni një vendim në lidhje me kërkesen ta konsultoni me komisionin e arsimit dhe sporteve, besoj se kanë kompetenca.

Nënkryetari K.Kita: Sapo thashë nëqoftëse keni ndonjë sygjërim më thoni ta referoj në përgjigje.

Këshilltare S.Dinellari: Por kjo duhet para se të jepni një përgjigje.

Këshilltar K.Pllaha: Mund të shtoj dhe unë diçka?

Pavarishtë se kjo është një shoqatë nuk është një shoqatë fitimprurëse, kështu që është një aktivitet sportiv ju e keni si prioritet zhvillimin e sportit në qytet, nuk besoj se duhet të kapemi me faktin që ish-trajneri nuk ka qënë bashkëpunues se shoqata është institucion zyrtar dhe kërkesa ka erdhur nga ana e gjykatës jo e trajnerit sepse është zvendësuar trajneri dhe besoj se mund të ndihmohet ok jo sponsorizim por pika e fushës mund të mbulohet qoftë në Qytezën e Fëmijëve qoftë në Pallatin e Sportit dhe e dyta në projektin e buxhitetit afatmesëm mesa pash ka 1 pikë që subensionon për Shoqatat Sportive që operojnë në qytetin e Korçës me 50 % të të gjitha tarifave që ato paguajnë dhe pagesa e qendrave sportive.

Nënkryetari K.Kita: Tani edhe njëherë ato tarifa që paguajnë Shoqatat ne patjeër që kemi në vëmendje të gjitha Shoqatat Sportive dhe këto kanë reduktuar tarifën që paguajnë jo lekët që japim ne se Shoqatave nuk i japim lekë ne, e kanë 1 favorizim ne patjetër u kemi vënë në dispozicion dhe ambientet e qytezës kundrejt tarifës që ka miratuar bordi i SHA-së.

Këshilltar K.Pllaha: Meqenëse ju jeni dhe në bordin e SHA-së të qëndërs sportive, nuk ka pasur asnjë shoqatë sportive apo ekupe sportive private që janë favorizuar në formë të dhënies të ambienteve në përdorim apo të aktivitetve që ata zhvillojnë.

Nënkryetari K.Kita: Të gjitha Shoqatat që janë drejtuar për të shfrytëzuar ambientet e qytezës kanë bërë 1 kontratë me tarifa të përcaktuara sipas vendimit të bordit.

Këshilltar K.Pllaha: Asnjë nuk është falas ?

Nënkryetari K.Kita: Patjetër që asnjë nuk është falas, ajo ka një listë me të gjitha tarifën e shfrytëzimit për ambiente jashtë, brenda ose palestrat e shkollave. Ka një kontratë me të gjitha oraret e përcaktuara kur do të zhvillojnë aktivitetet. Patjetër që falas është gjithë ekipi i Skënderbeut që është pjesë e institucionit të Bashkisë.

Këshilltar E.Haxhillari: Për të qënë i informuar me pjeësn e kësaj çfarë po ndodh meqenëse foli dhe Klajdi unë sdoja të flisja por po flas, ky ekip është një ekip privat që patjetër që trajneri mer lekët paguhet mer lek nga vajzat por ne kemi Klubin e sporteve si Skënderbeu që kemi të gjitha moshat dhe cdo fëmijë që vjen në klubin e Skënderbeut nuk paguan asnjë cent thjesht vjen stërvitet mer bluza sportive dhe të gjitha çfarë i shërbejnë sportit. Aktualisht ky ekip privat është një pol i ekipit të Skënderbeut nuk është ndihme por është ana tjetër sepse këët nuk e di duhet të pyesim personat në fjalë, pavarishtë kësaj unë jam që ne ta ndihmojmë sportin por duke qënë bashkë në këtë pikë ne nuk jemi bashkë për arsye të ndryshme. Megjithatë e rëndësishme janë

fëmijet që marrin pjesë dhe patjetër gjithë të tjerave unë jam i mendimt që këta fëmije duhen ndihmuar duke erdhur nga pjesa e klubit shumësportiv që cdo gjë është papagesë me trajner dhe me cdo lloj gjëje tjetër.

Këshilltar K.Pllaha: Me falni qe ta mbyll,besoj se do jete e nevojshme te vije dhe komisione per ta diskutuar dhe njehere kete ?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nëqoftëse ka sygjerime.

Këshilltar K.Pllaha: Po sepse me dijenine time i është kërkuar ekipit që ndeshjet që nuk kanë mundësi për fushe do të zhvillohen jashtë Korçe në qytetin e Pogradecit që ishte me e aftërta,tani nuk është noramle që një vajzë 15 vjet të detyrohet të dalë jashtë qytetit kur ka ambiente në qytet.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Në kërkesë ka vetëm këtë.

Nënkryetari K.Kita: Kërkesa është e përcaktuar çfarë kërkon, tani nëqoftese duhet të mbash përgjegjesi për këto që thua.

Këshilltar K.Pllaha: Po patjetër që mbaj përgjegjesi,sic mbani ju përgjegjesi që nuk është financuar asnjë ekip.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Klajdi nuk ka vetëm nga Korça ka dhe dhe jashtë nga Pogradeci komisioni të mblidhet dhe të bëjë 1 diskutim nëqoftëse ka.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kalojmë në pika të ndryshme,para se të kalojmë ka dërguar ekzeutivi një informacion që nga hera e kaluar është bërë gati po ja u vendosim në dispoziocion materialin e ardhur nga ekzekutivi dhe për çdo kërkesë tjetër që mund të kemi nga këshilltaret kundrejt ekzekutivit unë do të sygjeroja që të vijë paraprakisht dhe pastaj të vijë pas përgjigjes sepse ekzekutivi nuk mund të japë përgjigje sot për sot sidomos dhe për material të cilat mund të jenë dhe voluminoze sepse kanë kohën e zhvillimit të tyre kështu që po ja u vë në dispoziocion kështu që nëqoftëse ka diçka tjetër ?

Sekretare e Këshillit E.Naci: Me leje,në lidhje me kërkesat unë jam munduar të jem bashkëpunuese duke ja u lehtësuar pak këtë pjesën midis Këshillit dhe ekzekutivit por duke filuar që sot cdo lloj kërkesë me shkrim të dorëzohet tek protokolli minimalisht 10 ditë para mbledhjes këtë e kërkon rregullorja është rregullorja për ankesea,kërkesa komisionit 10 ditë përpara minimalisht ,me shkrim të dorëzohet tek protokolli dhe të meret përgjigjia kundrejt kësaj.

Këshilltar K.Kocibelli: Atëherë dhe për respekt të punës që është bërë ditën e hënë komisioni i ligjeve është prezantuar një raport për performance për vitin 2022 meqënëse unë e pash edhe zonjën që është e pranishme sot në sallë e cila e prezantoi këtë raport e mendova që ta themi ose ta flasim ose ne rast se zonëjs i jepet fjala të mundet ta interpretojë vetë raportin por gjithsesi ideja është që raporti është transparent tek faqja e Bashkisë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Do e bëj unë tani raportin publik para këshilltareve,do ja jap fjalen Zvendës Kryetares për ta bërë publike para këshilltareve.

Zv.Kryetare e Këshillit E.Mitre: Shkurtimisht nuk do ju ha shume kohë, është bërë një raport i performancës per vitin 2022 i punës te Bashkisë, ky raport është përpiluar nga Bashkia Korc ë me asistencen e pojektit Bashki të forta, projekti i cili na mbështet e ne si këshilltare në projekt janë marrë në konsiderate të gjithë programet të cilat janë mirtatuar për vitin 2022 dhe ne për vitin 2023 kemi bërë të njëjtën gjë. Shkurtimisht do ju lexoj një vështrim mbi zbatimin e buxhetit për vitin 2022. Gjaët vitit 2022 buxheti i Bashkisë është zbatuar në mënyre të ekuilibruar dhe është realizuar ne masën 75 % duke përdorur 64% të të ardhurave të Bashkisë fondet e paëprdorura janë transferuar në Bashki për buxhetin e vitit 2023 ku dy të tretat janë për projektet e filluara gjatë vitit 2022 edhe për tu përfunduar në vitin 2023 të gjitha projekt investimet edhe gjatë vitit 2022 fokusi i buxhetit të Bashkisë janë shërbimet publike për qytetarët. Bashkia ka rritur vlerën e investimeve për vitin 2022 me 38% krahasuar me vitin 2021,projektet e investimeve ne vitin 2022 janë realizuar në masën 35% krahasur me planin e këtij viti, Bashkia ka synuar të përmirësoje efincencen financiare edhe miëradministrimin e parave duke ofruar me shumë shërbime dhe cilësi më të lartë të tyre për komunitetin, desha të ndalesha thjesht në komisionin e mirëëqnie sociale meqënëse në programin e miërqënie sociale meqënëse jam pjesë e tij, është rritur numri i insepktimeve ët kryera për ndihmën ekonomike e cila ka sjellë dhe rritjen e numrit të famljeve të trajtuara me ndihmë ekonomike 97% e familjeve që kanë bërë kërkesë për ndihmë ekonomike janë përfituese të këtij shërbimi është rritur numri i personave të moshës të tretë dhe fëmijeve në qëndrat rehabilitore që kanë marrë shërbimin nga Bashkia kuptohet, është rritur numri i rasteve të këshillimit të fëmijeve minorene së bashku me numrin e fëmijeve të trajtuar nga njësia e mbrojtjes të fëmijeve, është rritur numri i viktimave të dhunës që asistohen nga ana psikologjike jo numri i të dhunuarve por ata që asistohen ndërsa për strehimin social shkurtimisht dhe këtu 3 gjëra të vogla,98% e aplikuesve për strehim social kanë përfituar këtë shërbim, është rritur numri i familjeve që kanë përfituar nga marja me qera e banesës sociale ndërsa eshte ulur numri i familjeve që marin kredi të bute për blejre banese krahasur me vitin 2021 janë rritur shpenzimet e Bashkisë për këtë program duke na treguar dhe njëhere rëndesine që i tregohet ndimehese se njeërzve që kanë nevojë. Nëqoftëse ju do dëshironi ta lexoni me imtesi sepse këtu janë të gjitha të detajuara ana financiare e Bashkisë mund ta kërkonit dhe do ja u përcjellim me email.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Eshtë publikuar ne faqen e Bashkisë.

Këshilltar E.Bregu: Mendova që informacioni do vinte në formë elektronike meqënëse informacioni është i bollshem dhe ka nevojë dhe të ripunohet e dyta,Sekretaria e Këshillit të Bashkisë duhet të japë informacionin e saktë dhe jo në gjuhë dykuptimëshe për të çorientuar lexuesin se çfarë informacioni po merr. Do i thoja Kryetares të Këshillit të marrë masa ndaj Sekretares të Këshillit që informacioni të përcillet i saktë pa dygjuhësh ose i dykuptimesh besoj se kjo është detyra e saj dhe duhet ta kryej siç duhet.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Elvin e rëndesishme është që ju të informoheni për at ëcka ju kërkonit,mënyra e informimit si dorazi si në formë elektonike është mënyre informimi dhe aq me tepër ja u bëjmë më të lehte ju ndoshta jeni mësuar në mënyre elektonike gjithsesi përgjigjen e ke tek ekzekutivi.

Ekzekutivi M.Balli: Për sa i përket ndërmarjes që janë në varësi të Bashkisë,për informacion që kërkonit e gjeni dhe në faqen e WEB-it të bashkisë,në faqet e transparencës ose mund ti dërgoni një shkresë kryetarit të bashkisë.

Këshilltar E.Bregu: Këtu kishte dhe informacione që skanë lidhje me këtë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka diçka tjetër në lidhje me këshilltarët?

Po Ada.

Këshilltare A.Permeti: Unë kisha dërguar një çështje në email për të gjithë këshilltarët ishte me shumë për pjesën e shqetësimit që ok informim në lidhje me që a është parashikuar për vitin 2023 në lidhje me vizimin.

Sekretare e Këshillit E.Naci: Cdo informacion me shkrim ju lutem në protokollin, për të gjithë.

Këshilltare A.Permeti: Dakort mund të ma kishe dërguar dhe me email që ta paraqisja me shkrim sepse e kanë vënë edhe afatin kohor të duhur.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Duhet të japim përgjigje për çdo pikë.

Këshilltare A.Permeti: Dakort nuk kërkoj përgjigje, për këtë çështje duhet ta ridërgoj shkresën kjo është. Unë thjesht një informacion që është parashikuar apo jo vijezi, nuk është ndonjë gjë e madhe herës tjetër sepse kur ishte kryetari këtu u përgjigj pyetjeve të cilat nuk ishin dërguar fare me email.

Sekretare e Këshillit E.Naci: U përmbahem disa pika të shkruara në rregullore.

Këshilltar L.Malaveci: Faleminderit për fjalën, unë meqënsëse është dhe ekzekutivi këtu dua të ndaj me ta, bëhet fjalë për një 23 vjeçar që quhet Kostika Kokonoci dhe ai vuan nga një sëmundje e rallë e shikimit pasi është diagnostikuar dhe nga doktori me këtë sëmundje ka bërë dhe një ndërhyrje në Turqi ka aplikuar për të përfutur kempin epror dhe pas 5 muaj kohësh përgjigja ka rezultuar negative, duke qënë se ai person aktualisht është me 20 % shikim dhe sa vjen me largimin e vitëve i largohet plotësisht shikimi.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Në Këshill në përveç se secili është i lirë të dakortësohet me raportin e ndihmës ekonomike mund ti jepet këtij individ në lidhje me anën ligjore të përfitimit apo jo nuk e vendosim në ka një komision të kempit epror të cilët vendosin se cilat kategori të diagnozave futen në kushtet e përfitimit apo jo, është që për këtë pjesë skemi themi për pjesën tjetër të ndihmës ekonomike secili nga këshilltarët është i lirë të shprehet për të ndihmuar duke filluar që nga unë dhe gjithë ju të tjerët sipas mundësive që kemi.

Këshilltare I.Seidolli: Në fakt unë kam 1 shqetësim për të cilën unë u njoha nëpërmjet medias dhe gazetarëve dhe ma kërkuan personalisht familjarët bëhet fjalë për qëndren atelia që është në varsi të shërbimeve sociale Korçe. Kjo qëndër posedon një mjet transporti, i cili bën të mundur transportimin e personave me aftësi ndryshe nga shtëpitë e tyre drejt qëndres. Ideja është që ky mjet është jashtë standarteve dhe me pamje vizive nëqoftëse e shikoni e kuptoni fare qartë që nuk mund të bëjë transportimin e këtyre personave që e theksoj janë me aftësi ndryshe, kështu që të merret në konsideratë që ky mjet të zvëndësohet me 1 mjet me kapacitete më moderne dhe më të përshtatshme për gjendjen e tyre

Sekretare e Këshillit E.Naci: Referuar rregullores në nenin 30 thuhet që brend tre muajve nga konstituimi duhet të krijohet grupet politike. Njoftimi të bëhet me shkrim e nënshkruar nga këshilltarët që bëjnë pjesë në grupin politik,grupi politik të ketë zgjedhur dhe kryesinë që përbëhet nga kryetari,nënkryetari dhe sekretari.

Këshilltare S.Dinellari: Besoj se ne herën e kaluar e kemi diskutuar si grup dhe e lam ëDevin si kryetar po meqënëse Devi nuk ndodhet sot nuk është së bashku me elementet e tjerë dhe emra të tjeër që do ti bashkohen grupit,të bëhen bashkë.

Sekretare e Këshillit E.Naci: Shume faleminderit secilit këshilltar të cilët më dërguan CV me modelin sipas standartit që ne kemi përcaktuar. Të gjitha këto CV do të na duhen për ti publikuar tek faqja e WEB-it,ju lutem CV duhet në shqip dhe me duhet ti kem të gjitha një model standart, ju lutem pjesa tjeër të cilët nuk ma kanë dërguar të ma nisin.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit Eva.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Unë personalisht nuk e di si do të administrohet,ne kemi bërë herët e kaluara por për këtë pjesën financiare.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ne flasim për mbështetje financiare ndryshe smund të...

Këshilltar L.Petri: Faleminderit Kryetare dhe unë falenderoj Lambertton për rastin që na solli dhe ju bej me dije që Shoqata e te Verbërve në Korçë,anetarët e bordit i ka 10 dhe ka vetëm 5 karrige ne 1 salle që ka lagështi,duhet tju them që nëqoftëse dëshironi mund të ftojme nga Shoqata vetë kryetarin i cili ka bërë dhe shkollë të lartë,ligji i takon që të punësohet por nuk është ende i punësuar në asnjë institucion, ka shumë halle me të verbërit dhe me vjen mirë që po merr dritë vëmendje ky institucion që ju siguroj që janë të panumërta.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Edhe dçika tjetër ne lidhje me këtë,nuk e di sa jeni të iinformuar po Këshilli i Qarkut mbështet Shoqatën e të Verbrëve për të gjitha Bashkitë e Qarkut me vlera monetare të cilat ata i përdorin sipas nevojave që kanë. Pra ka 1 mbështetje financiare nga Këshilli i Qarkut, Erjoni besoj e di.

Këshilltar L.Petri: Kam përshtypjen që ata e kanë kërkuar vetë dhe nuk u është plotësuar si kërkesë.

Këshilltar E.Nexhipi: Ta deklarojmë në institucion sepse te deklarosh këtu nëse e kanë kërkuar ose jo, ku e ke marrë vesh?

Këshilltar L.Petri: Nëqoftëse do, të them.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Gjithsesi do ti mbështesim.

Këshilltare S.Dinellari: Ju lutem këshilltare edhe diçka para se të mbyllet mbledhja e sotme,unë meqënëse dëgjova pak Znj.Përmeti. Unë e vlerësoj shumë kërkesën sepse është një problematikë për qytetin do doja dhe do sygjeroja që ti adresohen për shërbimet e transportiti.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit të gjithëve për mbledhjen e sotme. Ju uroj një ditë të mbarë!

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva Naçi

KRYETARI
ANA VERUSHI